



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA

Prot. 36

Dt. 16.01.2020

V E N D I M

Nr 8 Datë 16.01.2020

Për shpërblimin e punës së anëtarëve të jashtëm të komisioneve
dhe të njësive afatshkurtra të kërkim-studimit

Kryesia e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e saj të datës ____01.2020, në përputhje me nenin 5, pika 2/b; nenin 9, pikat 2, 4, 9; nenin 12, pika 1/b dhe nenin 18; si dhe me nenin 5, pika 2/c; nenin 19 të Ligjit nr.53/2019” Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”; me nenet 39,40, 41, 42 dhe 43; si dhe me nenet 44, 45, 46 të Statutit të ASHSH,

V E N D O S I:

1. Anëtarët e jashtëm të komisioneve shpërblehen për pjesëmarrje në mbledhje, në shumën 5500 (pesëmijëepesëqind) lekë për çdo pjesëmarrje, por jo më shumë se për 6 (gjashtë) mbledhje në vit.
2. Në përputhje me nenin 45, pika 2 të Statutit, anëtarët e njësive afatshkurtra të kërkim-studimit, që ngrihen pranë ASHSH shpërblehen sipas kushteve të përcaktuara në kontratë, me kohë të plotë a të pjesshme, dhe/ose me shpërblim për produkt shkencor.
3. Për anëtarët e kontraktuar me kohë të plotë, si referencë do të shërbejë niveli i pagave në shkollat e larta publike për personat me tituj dhe grada shkencore, si dhe niveli i pagave të ASH për kategoritë e tjera. Anëtarët e kontraktuar me kohë të pjesshme të paguhen në masën 25-40 % të pagës përkatëse.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Sekretari Shkencor, Kancelari dhe Sektori i Finances.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

AKADEMIK SKENDER GJINUSHI

